



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

DREJTORIA E SIGURIMIT TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

Nr. 2152 prot.

Tiranë, më 9.10 2017

Bibliografia e Informacionit të Deklasifikuar në DSIK.

Me vendim nr. 2152, datë 15.9.2017, Komisioni i Deklasifikimit dhe i Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "Sekret shtetëror" (KDZH), mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr.124, datë 15.3.2001 "Për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror"", vendosi deklasifikimin nga niveli "Konfidencial" dosjen me nr. 28, datë 12.8.2013 "Për zbatimin e kontratës për godinën e DSIK" dhe dosjen me nr. 29, datë 12.8.2013 "Dosje e prokurimit shtesë kontrate rikonstruksioni i godinës në DSIK".

Dosjet u deklasifikuan bazuar në nenin 13, kreu III, të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "Sekret shtetëror"", i ndryshuar.

Arsyeja e deklasifikimit: Interesi shtetëror është më i rëndësishëm se nevoja për ti mbajtur ato të klasifikuara.

Përmbajtja e shkurtër e dosjeve:

- Kontratë për punimet e ndërtimit midis investitorit "DSIK" dhe sipërmarrësit "Operatori Ekonomik "Bregu sha"";
- Preventiv me objekt "Punime rikonstruksioni në DSIK";
- Situacion përfundimtar për kontratën për punimet e ndërtimit midis investitorit "DSIK" dhe sipërmarrësit "Operatorit Ekonomik "Bregu sha"";
- Fatura tatimore shitjeje të shitësit "Bregu sha";
- Kontratë shtesë për punimet e ndërtimit midis investitorit "DSIK" dhe sipërmarrësit "Operatorit Ekonomik "Bregu sha"";
- Preventiv për kontratën shtesë për punimet e ndërtimit;
- Shkresë përcjellëse e "Operatorit Ekonomik "Bregu sha"", nr. 94, datë 20.6.2013, me lëndë: "Bashkëlidhur situacioni për punimet shtesë", drejtuar DSIK etj.

Një kopje e kësaj bibliografie do të mbahet nga sekroni përkatës i Drejtorisë së Sigurimit, Administrimit të Dokumentave dhe Regjistrimit Qendror, në DSIK.



DREJTORI

Dorian Tola